REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY
Nr.Prot: 391/13 Data: 15.01.2013
Br. Prot: Datum:
Prot. No.: Date:
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 391/13
Datë 15.01.2013

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 15.12.2012 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Qendrës Rajonale për Aftësim Profesional, Gjilan, për periudhën: 15/12/2012 - 31/07/2015 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

1.1. Teknologji Informative dhe e komunikimit - (niveli i KKK-së II)

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Kurrikuli është paksa i vjetër, prandaj rekomandohet që ky kurrikul të përditësohet apo edhe të kalohet komplet në standardin ECDL, meqenëse modulet janë të ngjashme me këtë standard.
- Të përshtatet paketa mësimore e trajnimit me kërkesat e tregut të punës
- Te përpilohet plani për trajnimin e trajnerit me paketat më të reja mësimore
- Të krijohen procedurat e monitorimit dhe matjes së përformancës
- Qendra nuk ka ndonjë plan marketingu ku do të inkurajoheshin kandidatë potencial për trajnim, rekomandohet që qendra të krijoj një plan të marketingut në mënyrë të të bëhet informimi më i mire. Si mungesë e kësaj kjo qendër ka numër të vogël të kandidateve.

Afati përmbushjes se këtyre kushteve është: 01.03.2013

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, me datë:15.12.2012, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

-Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
-Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
-Raporti i Vetë-vlerësimit;
-Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet:

- QRAP, Gjilan;
- AKK-së.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi